



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2442/Prot.

Laç, më 2 / 06 2025

VENDIM

Nr. 13 Datë 28 / 05 2025

“PËR SHPALLJEN E DATËS 10 GUSHT SI “FESTA E QYTETIT TË LAÇIT”

Në mbështetje të nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 25, pikat 2 dhe 4; neni 53, pika 3b; Rregullore e funksionimit të Keshillit Bashkiak Kurbin, miratuar me, neni 66, pika 7; si dhe neni 92; me propozimin e një grupi këshilltarësh të Këshillit Bashkiak Kurbin, dhe në kuadër të promovimit të traditës, bashkimit komunitar dhe përfshirjes së diasporës emigrante në jetën sociale të qytetit, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. **Të shpallë datën 10 Gusht si “Festa e Qytetit të Laçit”**, një festë vjetore që do të organizohet në një nga sheshet kryesore të qytetit, me qëllim nxitjen e takimeve mes qytetarëve dhe emigrantëve të kthyer për pushime pranë familjeve të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi Ngarkohet Drejtoria e Kulturës pranë Bashkisë Kurbin që, në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse, të hartojë dhe zbatojë një axhendë vjetore aktiviteteve kulturore, artistike dhe argëtuese në kuadër të kësaj feste.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë.

>Drejtoria e Arsimit ,Kultures dhe Sporteve.

>Arkivit

Sekretari i Këshillit
Arber LEKA

Kryetare e Këshillit
Edlira LLESHI